



Komisioni
Evropian

Evropa pa kufij

Zona Schengen




Migrimi dhe
Punët e
Brendshme

Zona Schengen

- Shtetet anëtare të BE-së, që janë pjesë e zonës Schengen
- Shtetet anëtare të BE-së, që nuk janë pjesë e zonës Schengen
- Shtetet joanëtare të BE-së, që janë pjesë e zonës Schengen

AT	Austria
BE	Belgjika
BG	Bullgaria
CH	Zvicra
CY	Qipro
CZ	Republika Çeke
DE	Gjermania
DK	Danimarka
EE	Estonia
EL	Greqia
ES	Spanja
FI	Finlanda
FR	Franca
HR	Kroacia
HU	Hungaria
IE	Irlanda
IS	Islanda
IT	Italia
LI	Lihtenshtajni
LT	Lituania
LU	Luksemburgu
LV	Letonia
MT	Malta
NL	Holanda
NO	Norvegjia
PL	Polonia
PT	Portugalia
RO	Rumania
SE	Suedia
SI	Sllovenia
SK	Sllovakia
UK	Mbretëria e Bashkuar



Shënim: Zgjerimi i fundit i zonës Schengen ka ndodhur më 19 dhjetor 2011, me anëtarësimin e Lihtenshtajnit.

Evropa pa kufij

Zona Schengen

Historia filloi në vitin 1985, kur pesë shtete të BE-së, vendosën të heqin kontrollet në kufijtë e brendshëm - dhe kështu u krijua zona Schengen. Në një kontinent kur dikur kombet derdhën gjakun për mbrojtjen e territoreve të tyre, tani kufijtë ekzistojnë vetëm në hartë. Evropianët bëjnë më shumë se 1.25 miliardë udhëtime brenda zonës Schengen çdo vit. Evropa pa kufij të brendshëm sjell përfitime të mëdha edhe për ekonominë, e cila tregon se sa e prekshme, e popullarizuar dhe e suksesshme është zona Schengen. Ajo ka rëndësi për jetën tonë të përditshme dhe për shoqëritë tona. Ne duhet ta ruajmë dhe rifuqizojmë këtë arritje të përbashkët.

Janë dashur shumë vite për eliminimin e kufijve, arritjen e sigurisë dhe ndërtimin e besimit pas dy luftërave botërore shkatërruese. Krijimi i zonës Schengen është njëra nga arritjet më të mëdha të BE-së, dhe është akt i pakthyeshëm. Tani, lëvizja e lirë e bën Evropën më të vogël dhe na bashkon. Gëzojeni këtë të drejtë! Hipni në tren apo veturë dhe vizitoni fqinjët tuaj. E gjithë kjo është e mundur pa menduar dy herë për kufijtë!

Udhëtim të këndshëm!

Dimitris Avramopoulos,

Komisionar për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi



Zona Schengen

Zona Schengen garanton udhëtim të pakufizuar brenda territorit të 26 vendeve, shtëpi e mbi më shumë se 400 milionë qytetarëve

Zona pa kontrolle në kufijtë e brendshëm

Aktualisht, zona Schengen përbëhet nga 26 vende evropiane (nga të cilat 22 janë shtete të BE-së): Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Gjermania, Estonia, Greqia, Spanja, Franca, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Portugalia, Sllovenia, Sllovakia, Finlanda dhe Suedia, së bashku me Islandën, Lihetnshtajnin, Norvegjinë dhe Zvicrën.

Të qenit pjesë e zonës pa kontrolle në kufijtë e brendshëm nënkupton që këto vende:

- nuk kryejnë kontrolle në kufijtë e tyre të brendshëm (përkatësisht kufijtë ndërmjet dy shteteve anëtare të zonës Schengen);
- kryejnë kontrolle të harmonizuara, bazuar në kriteret e përcaktuara qartë, në kufijtë e tyre të jashtëm (përkatësisht kufijtë ndërmjet një shteti që është anëtar i zonës Schengen).

dhe një shteti që nuk është anëtar i zonës Schengen).

Si rezultat, qytetarët e BE-së, dhe qytetarët që nuk janë shtetas të BE-së, mund të lëvizin lirshëm brenda zonës Schengen dhe të kontrollohen vetëm kur kalojnë kufirin e jashtëm.

Bullgaria, Kroacia, Qipro, Irlanda, Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar janë shtete të Bashkimit Evropian që nuk janë ende, anëtarë të zonës Schengen. Për këtë shkak, një fluturim nga njëri nga këto shtete në një shtet që është anëtar i zonës Schengen konsiderohet fluturim i jashtëm dhe i nënshtrohet kontrolleve kufitare. Megjithatë, qytetarët e BE-së, kanë të drejtë të lëvizin lirshëm gjatë udhëtimit brenda BE-së, pavarësisht nëse vendi është anëtar i zonës Schengen apo jo. Në parim, gjatë hyrjes në një shtet të BE-së, i cili nuk është anëtar i zonës Schengen, qytetarët e BE-së, i nënshtrohen vetëm kontrolleve minimale për të verifikuar identitetet e tyre në bazë të dokumenteve të udhëtimit (pasaportës apo letërnjoftimit).

Në kufijtë e brendshëm ...

... nuk i nënshtroheni kontrolleve kufitare.

... shtetet që janë anëtare të zonës Schengen duhet t'i largojnë të gjitha pengesat për rrjedhën fluide të trafikut rrugor, si p.sh. kufizimet e panevojshme të shpejtësisë.

... mund të ketë kontrolle nga policia, por vetëm në bazë të informacioneve të policisë në lidhje me kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë publike apo krimit të dyshuar ndërkufitar.

...kontrolltet e sigurisë mund të kryhen në porte dhe aeroporte, por vetëm për të verifikuar identitetin e personit.

Nëse mendoni se i jeni nënshtrohet kontrollit të paligjshëm në kufijtë e brendshëm, ju mund të paraqitni ankesë tek Komisioni Evropian: http://ec.europa.eu/atwork/applying-eu-law/make_a_complaint_en.htm.



Anëtarësimi në zonën Schengen

Për tu anëtarësuar në zonën Schengen, shtetet anëtare të zonës Schengen është dashur të demonstrojnë se janë në gjendje të:

- marrin përgjegjësi për kontrollimin e kufirit të jashtëm të zonës në emër të shteteve të tjera anëtare të zonës Schengen dhe për dhënien e vizave uniforme për qëndrim të shkurtër (vizat Schengen);
- bashkëpunojnë në mënyrë efikase me shtetet e tjera anëtare të zonës Schengen në mënyrë që të ruajnë një nivel të lartë të sigurisë pas heqjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm;
- zbatojnë grupin e rregullave Schengen, si rregullat mbi kontrollin e kufitare në tokë, det dhe ajër, dhënien e vizave, bashkëpunimin policor dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- lidhen dhe shfrytëzojnë Sistemin e Informimit Schengen (SIS) dhe Sistemin e Informimit për Viza (VIS).

Shtetet anëtare të zonës Schengen i nënshtrohen vlerësimeve periodike për të kontrolluar nëse janë duke zbatuar në mënyrë të duhur rregullat e Schengenit.



Një zonë e sigurtë

Për të ofruar siguri brenda zonës pa kufij, shtetet anëtare të zonës Schengen shkëmbejnë informacione për trajtimin e krimit të organizuar ndërkufitar dhe të terrorizmit. Ato kanë rritur bashkëpunimin me policinë, në veçanti nëpërmjet ndjekjes së menjëhershme, mbikëqyrjes ndërkufitare, krijimit të qendrave, ekipeve të përbashkëta të policisë, si dhe shfrytëzimit të SIS.

Ndjekja e menjëhershme u mundëson zyrtarëve policorë nga një shtet që është anëtar i zonës Schengen, të cilët i kapin kriminelët gjatë kryerjes së një veprë të rëndë kriminale, që të ndjekin kryesit përgjatë kufirit dhe t'i mbajnë ata në territorin e një shteti tjetër anëtar në Schengen.

Mbikëqyrja ndërkufitare u mundëson zyrtarëve policorë që të vazhdojnë mbikëqyrjen e kriminelëve të dyshuar, madje edhe përgjatë kufijve të brendshëm të zonës Schengen.

Si struktura shumë të dukshme të bashkëpunimit të përmirësuar, shtetet anëtare të zonës Schengen deri më tani kanë krijuar rreth 50 qendra bilaterale apo multilaterale të bashkëpunimit policor në Evropë, si dhe një numër të konsiderueshëm të ekipeve të përbashkëta.

Kjo mundëson shkëmbimin e shpejtë të informacioneve në nivel rajonal dhe reagimet e shpejta ndaj kërcënimeve të pashmangshme në rajonet kufitare.

Rregullat Schengen, ende ua lejojnë autoriteteve kombëtare që t'i rivendosin përkohësisht, në raste të jashtëzakonshme kontrollet në kufijtë e brendshëm, në rast të kërcënimit serioz ndaj sigurisë apo mungesave serioze në kufirin e jashtëm që mund të shkaktojnë rrezik për funksionimin e përgjithshëm të zonës Schengen.

Në mënyrë që të lehtësohet udhëtimi i ligjshëm pa dëmtuar sigurinë, BE-ja financoi shtetet e saja anëtare nëpërmjet pjesës "Kufijtë" të Fondit të Brendshëm të Sigurisë. Gjatë periudhës 2014-2020, janë në dispozicion gjithsej 2.76 miliardë euro për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve të jashtëm, në mënyrë që të trajtohet më mirë migrimi i parregullt dhe të përmirësohet procesimi i aplikacioneve për viza Schengen. Për më tepër, për rritjen e bashkëpunimit policor dhe shkëmbimit të informacioneve në vetë zonën Schengen, BE-ja ofron 1 miliardë euro nëpërmjet pjesës "Policia", të Fondit të Brendshëm të Sigurisë.



© European Union





Sistemi i informimit i Schengen-it

Sistemi i Informimit i Schengen-it (SIS), është krijuar për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë së brendshme brenda shteteve që janë anëtare të zonës Schengen për mungesë të kontrolleve në kufijtë e brendshëm. Është një sistem i madh i informimit që u mundëson autoriteteve policore, të migracionit, gjyqësore dhe autoriteteve të tjera që t'i fusin të dhënat dhe të konsultohen në lidhje me paralajmërimet për personat e zhdukur, personat apo objektet që ndërlidhen me veprat kriminale dhe personat që nuk janë shtetas të BE-së, të cilëve nuk u lejohej të hyjnë apo qëndrojnë në zonën Schengen. Në këtë mënyrë, SIS është baza e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit. Në të njëjtën kohë, kontribuon në masë të madhe në mbrojtjen e kufijve të jashtëm të Schengen-it.

E drejta për qasje në SIS

Çdo person ka të drejtë të ketë qasje në të dhënat e tij/saj personale në SIS dhe të kërkojë përmirësimin apo largimin e tyre.

Nëse nuk jeni shtetas i BE-së, ju mund ta adresoni kërkesën tuaj tek konsullata e ndonjë shteti që është anëtar i zonës Schengen.

Nëse jeni qytetarë të një shteti që është anëtar i zonës Schengen, mund ta adresoni kërkesën drejtpërdrejtë tek autoriteti kompetent kombëtar që është përgjegjës për dhënien e paralajmërimit ose në mënyrë indirekte nëpërmjet autoritetit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave.

Për më shumë informacione në lidhje me atë se si të kërkohet qasja në të dhënat tuaja, shihni udhëzimet mbi mbrojtjen e të dhënave në ueb-faqen e mbikëqyrësit evropian: <https://secure.edps.europa.eu/EDPSWEB/edps/Supervision>

Zona Schengen kufizohet me 42 673 km kufij detar dhe 7 721 km kufij tokësor

Një zonë me kufij të jashtëm të përbashkët

Shtetet anëtare të zonës Schengen ndajnë një kufi të jashtëm për të cilin, për mungesë të kontrolleve në kufij të brendshëm, janë përgjegjës së bashku për të ofruar siguri brenda zonës Schengen. Megjithatë, kontrollimi efikas i kufirit të jashtëm nuk nënkupton që Evropa është kthyer në një 'fortesë'. Përkundrazi, është shumë e rëndësishme të inkurajohen udhëtimet afariste dhe turizmi për hir të ekonomisë evropiane. Kufiri i jashtëm gjithashtu duhet të mbetet i hapur për njerëzit që vijnë për punë apo që kërkojnë strehim nga lufta dhe persekutimi.

Shtetasit nga vende të caktuara që nuk janë anëtare të BE-së duhet të kenë vizë për të hyrë në zonën Schengen. Shtetet që janë anëtare të zonës Schengen kanë rregulla të përbashkëta për dhënien e vizave Schengen për qëndrim të shkurtër, të

cilat janë të vlefshme brenda të gjithë zonës Schengen. Vizat u lejojnë personave që të qëndrojnë dhe të udhëtojnë në territoret e shteteve që janë anëtare në zonën Schengen për maksimum 90 ditë në çfarëdo periudhe prej 180 ditësh.

Rregullat Schengen gjithashtu përfshijnë regjimin lokal të trafikut kufitar, i cili e bën më të lehtë për shtetasit e vendeve fqinje që nuk janë anëtare të BE-së, e që jetojnë në afërsi të kufirit, të hyjnë në zonën Schengen. Shtetet që janë anëtare të zonës Schengen mund të hartojnë marrëveshje me vendet e tyre fqinje që nuk janë anëtare të BE-së, që u mundësojnë banorëve kufitar, të cilëve iu duhet shpesh të kalojnë në zonën Schengen, që ta bëjnë këtë pa iu nënshtruar kontrolleve të rregullta kufitare apo pa pasur nevojë për vizë Schengen.



Në të majtë: Barka patrulluese e Rio Tambre e Gardës Civile Spanjolle duke patrulluar në afërsi të Gran Canaria Ishujve Canary. Kjo barkë është financuar nga Fondi i BE-së për Kufij të Jashtëm.



Në të djathtë: Rojet kufitare ushtarake të Norvegjisë nën mbikëqyrjen e policisë nga distrikti i policisë në Ostfnnmark, patrollojnë në kufirin me Rusinë në afërsi të qytetit të Kirkenes në Norvegjinë Veriore. Sajat me motor të policisë dhe një pjesë e veshjeve dhe pajisjeve mbështeten nga Fondi i BE-së për Kufij të Jashtëm.

Në kufijtë e jashtëm...

... shtetasit e BE-së i nënshtrohen kontrolleve minimale për të verifikuar identitetet e tyre në bazë të dokumenteve të udhëtimit.

... qytetarët joshketas të BE-së duhet të paraqesin një dokument valid të udhëtimit dhe një vizë, nëse kërkohet, apo leje qëndrimi, si dhe dokumente që justifikojnë qëllimin e qëndrimit të tyre dhe dëshmojnë që ata posedojnë burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur veten gjatë qëndrimit të tyre.

A e keni ditur se...

... lista e përditësuar në mënyrë të rregullt, e cila përmban vendet shtetasit e të cilave duhet të kenë vizë për të hyrë në zonën Schengen është në dispozicion në ueb-faqen e Drejtorisë së Përgjithshme për Migrim dhe Punë të Brendshme:

http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/borders-and-visas/visa-policy/index_en.htm.

... aplikacioni për vizë Schengen duhet të paraqitet në konsullatën e shtetit që është anëtar i zonës Schengen të destinacionit kryesor, i cili mund të ofrojë gjithashtu informacione të detajuara në lidhje me procedurën e aplikimit.

Sa gjatë mund të qëndroni në zonën Schengen me ose pa vizë Schengen?

Nëse nuk jeni shumë të sigurt se sa ditë mund të qëndroni brenda zonës Schengen, llogaritni numrin e ditëve që ju mbetin me llogaritësin e vizave për qëndrim të shkurtër: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/index_en.htm

Sistemi informues për vizë

Sistemi Informues për Vizë (VIS) është një sistem i TI-së, që lidh konsullatat Schengen në vendet që nuk janë anëtare të BE-së, autoritetet kompetente kombëtare dhe të gjitha pikëkalimet kufitare të jashtme të shteteve që janë anëtare të zonës Schengen. Kjo u mundëson autoriteteve për vizë të shteteve që janë anëtare të zonës Schengen që të shkëmbejnë informacione mbi aplikimet për vizë, rojeve kufitare që të verifikojnë përdorimin e të dhënave biometrike (p.sh. shenjat e gishtërinjve), që personi që paraqet vizën është bartësi i duhur dhe autoriteteve kompetente që të identifikojnë personat e gjetur në territorin e zonës Schengen pa dokumente apo me dokumente të rreme. VIS përdoret edhe nga autoritetet kompetente për azil.



Çfarë nënkupton Schengeni për udhëtarët?

Evropianët bëjnë mbi 1.25 miliardë udhëtime brenda zonës Schengen çdo vit

Çfarë nëse jam nga shteti i BE-së?

Francesca është studente italiane, e cila ëndërron të vizitojë Suedinë me miqtë e saj. Ajo tashmë e ka blerë biletën e saj inter-rail, por nuk e di se cilat dokumente të udhëtimit i nevojiten apo nëse duhet të përmbushë formalitete të veçanta ligjore. Si një qytetare e BE-së, Francesca ka të drejtë të hyjë në të gjitha shtetet e BE-së, pas paraqitjes së pasaportës apo letërnjoftimit valid, por ajo nuk duhet t'i paraqesë ato kur udhëton brenda zonës Schengen. Megjithatë, ajo duhet të bartë një pasaportë apo letërnjoftim të vlefshëm, sepse autoritetet mund të kërkojnë nga ajo që të dëshmojë identitetin e saj.

Peter është austriak. Ai dëshiron të shkojë në Norvegji, por nuk e di nëse zbatohen të njëjtat rregulla mbi viza dhe pasaporta në Norvegji si në shtetet e BE-së. Edhe pse Norvegjia nuk është anëtare e BE-së, është anëtare e zonës Schengen, ndaj zbaton rregulla të lëvizjes së lirë. Nga ky shkak, Peter duhet të mbajë vetëm një pasaportë apo letërnjoftim valid në mënyrë që të jetë në gjendje të dëshmojë identitetin e tij, nëse i kërkohet.

Danuta është nga Polonia dhe punon në Bruksel. Muajin tjetër ajo duhet të marrë pjesë në një takim afarist që do të zhvillohet në Varshavë, përkatësisht vendi i saj i lindjes ku jetojnë prindërit e saj. Ajo dëshiron të shkojë në këtë udhëtim

së bashku me beben e saj Ewa për të kaluar më shumë kohë me prindërit e saj. Si qytetare të BE-së, Danuta dhe Ewa kanë të drejtë të udhëtojnë kudo në BE dhe në zonën Schengen. E drejta e tyre nuk varet nga rrethanat e tyre, përkatësisht nëse janë duke udhëtuar për arsye profesionale apo private. Danuta duhet të sigurohet që ajo dhe Ewa kanë pasaporta apo letërnjoftim individual.

Angel është spanjoll. Ai udhëton për në Bullgari pothuajse çdo muaj për të vizituar të dashurën e tij. Edhe pse Bullgaria është anëtare e BE-së, nuk është ende anëtare e zonës Schengen - e njëjta vlen edhe për pesë shtete tjera të BE-së (Kroacia, Qipro, Irlanda, Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar). Kjo nënkupton se gjatë udhëtimit për në Bullgari dhe anasjelltas, ai duhet të paraqesë pasaportën apo letërnjoftimin e tij dhe t'i nënshtrohet kontrolleve të zakonshme minimale kufitare për qytetarët e BE-së.

A e keni ditur se ...

... informacionet praktike mbi udhëtimin në Evropë janë në dispozicion në portalin Your Europe: ec.europa.eu/youreurope.

... Qendra Evropiane për Kontakt të Drejtpërdrejt i përgjigjet pyetjeve përmes telefonit (00800 67891011) dhe e-mail: europa.eu/europedirect.

Në vitin 2013, mbi 16 milionë viza Schengen janë dhënë për qytetarët që nuk janë shtetas të BE-së për të udhëtuar në zonën Schengen

Çfarë nëse jam shtetas i një vendi që nuk është anëtar i

BE-së?

Martine është studente kanadeze e cila ka fituar një bursë, e cila do t'ia mundësojë qëndrimin prej dy muajsh në Universitetin Sorbonne në Paris për hulumtim për punimin e diplomës. Para se të kthehet në Kanada, ajo do të dëshironte të udhëtonte për tri javë nëpër Greqi, Spanjë dhe Itali. Si qytetare e një vendi që nuk është anëtar i BE-së, Martine mund të hyjë dhe udhëtojë brenda territorit të zonës Schengen deri në 90 ditë, nëse i përmbush kushtet e caktuara. Së pari, ajo duhet të ketë një pasaportë valide. Ajo gjithashtu duhet të jetë në gjendje të demonstrojë qëllimin e udhëtimit të saj, se ajo ka para për të jetuar në Evropë për kohëzgjatjen e synuar të qëndrimit të saj dhe se ajo ka biletë kthyesë (apo që ka para të mjaftueshme për ta blerë një të tillë). Si qytetare kanadeze, Martine është e përjashtuar nga kërkesa për vizë për qëndrim të shkurtër (Schengen).

Punjit është nga India. Ai është duke planifikuar t'i kalojë pushimet e tij duke vizituar disa shtete që janë anëtare të zonës Schengen: Greqinë, Spanjën, Francën dhe Italinë. Ai do të qëndrojë në Evropë për një muaj. Punjit duhet të marrë vizë për qëndrim të shkurtër për të shkuar në Evropë sepse India i përket vendeve që nuk janë anëtare të BE-së, shtetasit e të cilëve duhet të kenë viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm të zonës Schengen. Pasi që Punjit nuk ka destinacion kryesor, ai duhet të aplikojë për vizë në ambasadën apo konsullatën e shtetit të BE-së, ku ai do të qëndrojë më së gjati. Nëse ai qëndron në shtete të ndryshme që janë anëtare të zonës Schengen për periudha të njëjta kohore, ai duhet të aplikojë në konsullatën e shtetit të hyrjes në zonën Schengen. Viza e marrë do t'i mundësojë atij të lëvizë nëpër zonën Schengen.

Hisham është tunizian. Ai jeton në Gjermani dhe i kalon pushimet me prindërit e tij në Tunizi. Gjatë kthimit nga Tunizia, ai dëshiron të shkojë për të vizituar vëllain e tij në Portugali. Ai ka leje valide të qëndrimit të lëshuar në Gjermani, e cila është anëtare e zonës Schengen.

Leja e qëndrimit, së bashku me një dokument valid të udhëtimit, siguron që ai nuk ka nevojë të aplikojë për vizë Schengen. Si qytetar që nuk ka shtetësi të BE-së, Hisham mund të hyjë në Portugali, një tjetër shtet që është anëtar i zonës Schengen, për qëndrim të shkurtër pa vizë, vetëm me pasaportën e tij dhe leje qëndrimin e lëshuar në Gjermani. Nëse Hisham do të kishte leje qëndrim të lëshuar nga një shtet i BE-së që nuk është anëtar i zonës Schengen, ai nuk do të mund të hynte në zonën Schengen pa vizë për qëndrim të shkurtër.

Solinas është nga Bolivia. Ajo do të dëshironte të zhvendosej në Spanjë për shkak se ka gjetur një punë në Madrid. Pasi që Solinas është duke planifikuar të qëndrojë në Madrid për më shumë se 90 ditë, ajo duhet të marrë një vizë për qëndrim më të gjatë apo leje qëndrim. Për disa kategori të punonjësve, si punonjësit shumë të aftë apo hulumtuesit, e drejta e BE-së përcakton kriteret, të cilat qytetarët joshketas të BE-së duhet t'i përmbushin për të qëndruar dhe punuar në BE. Për kategoritë e punonjësve, të cilët nuk janë përfshirë në kuadër të së drejtës së BE-së, shtetet që janë anëtare të zonës Schengen duhet t'i përcaktojnë kriteret e për dhënien e vizave për qëndrim të gjatë dhe lejeve të qëndrimit.





Ndërtimi i zonës Schengen ka filluar në vitin 1985, kur pesë vende nënshkruan Marrëveshjen Schengen që përcakton heqjen graduale të kontrolleve në kufijtë e përbashkët. Marrëveshja është plotësuar me Konventën Zbatuese Schengen të vitit 1990, e cila përcakton heqjen përfundimtare të kontrolleve në kufij të brendshëm, si dhe një seri të masave të nevojshme shoqëruese. Konventa ka fuqizuar kontrollet në kufijtë e jashtëm, ka përcaktuar procedurat për dhënien e vizave uniforme, ka krijuar SIS, ka ngritur bashkëpunimin policor në kufijtë e brendshëm dhe ka përmirësuar veprimet kundër trafikimit të drogave.

Data me rëndësi

Marrëveshja Schengen është emëruar sipas një fshati të vogël në Luksemburg që gjendet në pikën ku kufijtë e saj takohen me kufijtë e Gjermanisë dhe Francës. E filluar si një iniciativë ndërmjet qeverive, bashkëpunimi Schengen tani është pjesë e ligjeve dhe rregullave të BE-së

Qershor 1985

Nënshkruhet marrëveshja Schengen nga: Belgjika, Gjermania Franca, Luksemburgu dhe Holanda

Qershor 1990

Konventa zbatuese e Marrëveshjes Schengen, nënshkruhet nga: Belgjika, Gjermania, Franca, Luksemburgu dhe Holanda

Mars 1995

Hyn në fuqi Konventa, ndaj hiqen kontrollet kufitare ndërmjet Belgjikës, Gjermanisë, Spanjës, Francës, Luksemburgut, Holandës dhe Portugalisë (Spanja dhe Portugalia e kanë nënshkruar marrëveshjen në qershor të vitit 1991)

Tetor 1997

Hiqen kontrollet kufitare me Italinë (marrëveshja e nënshkruar në nëntor të vitit 1990)

Dhjetor 1997

Janë hequr kontrollet kufitare me Austrinë (marrëveshja e nënshkruar në prill të vitit 1995)

Maj 1999

Traktati i Amsterdimit integron bashkëpunimin Schengen në kornizën ligjore të BE-së



Jean Weyrich, Archives Luxemburger Wort

14 qershor 1985 — Marrëveshja Schengen nënshkruhet nga: Wim van Eekelen (NL), Robert Goebbels (LU), Catherine Lalumière (FR), Waldemar Schreckenberger (DE) dhe Paul De Keersmaecker (BE).

Janar 2000

Hiqen kontrollet kufitare me Greqinë (marrëveshja e nënshkruar në nëntor të vitit 1992)

Mars 2001

Hiqen kontrollet kufitare me: Danimarkën, Finlandën, Suedinë, Islandën dhe Norvegjinë (marrëveshja e nënshkruar në dhjetor të vitit 1996)

Dhjetor 2007

Hiqen kontrollet kufitare tokësore dhe detare me: Republikën Çeke, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Hungarinë, Maltën, Poloninë, Slloveninë dhe Sllovakinë

Mars 2008

Hiqen kontrollet kufitare në aeroporte me: Republikën Çeke, Estoninë, Letoninë, Lituani, Hungarinë, Maltën, Poloninë, Slloveninë dhe Sllovakinë

Dhjetor 2008

Hiqen kontrollet kufitare tokësore me Zvicrën (marrëveshja e nënshkruar në tetor të vitit 2004)

Mars 2009

Hiqen kontrollet kufitare në aeroporte me Zvicrën

Dhjetor 2011

Hiqen kontrollet kufitare me Lihtenshtajnin (marrëveshja e nënshkruar në shkurt të vitit 2008)



Çfarë më tutje?

BE-ja aktualisht është duke punuar në programin 'Smart border' për kufirin e jashtëm. Ai përbëhet nga një sistem për hyrje/dalje, i cili do të i përmirësojë kontrollet kufitare dhe do të luftojë migrimin e parregullt përdorur për të lehtë kalimin kufitar për udhëtarët e shpeshtë dhe të kontrolluar paraprakisht.

BE-ja gjithashtu është duke punuar në modifikimin e procedurës për viza për të ndërtuar relacione më të mira

me fushat tjera të politikave, siç është turizmi, dhe për të lehtësuar më tej procedurat për udhëtarët e shpeshtë. Një lloj i ri i vizave — 'viza turistike' — gjithashtu është duke u shqyrtuar, ndërkohë që e njëjta do ta lejonte një person të qëndrojë në territorin e dy e më shumë shteteve që janë anëtare të zonës Schengen për një kohëzgjatje prej më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se një vit (me mundësi zgjatjeje edhe për një vit shtesë).

Më shumë informacione ...

... mbi ligjet dhe rregullat Schengen mund të gjeni në ueb-faqen e Drejtorisë së Përgjithshme për Migrim dhe Punë të Brendshme: ec.europa.eu/home-affairs/doc_centre/borders/borders_schengen_en.htm.

... mbi ligjet dhe rregullat e migrimit të shteteve të BE-së mund të gjeni në portalin e BE-së për imigrim: ec.europa.eu/immigration.

Për më shumë informata rreth Bashkimit Evropian në Kosovë



Qendra Informative dhe Kulturore e BE-së

Rruga "Nëna Terezë" nr. 63, Prishtinë 10000, Kosovë

T: +381 (0) 38 25 99 99

F: +381 (0) 38 25 99 25

M: +377 (0) 44 50 95 10

E: pr@euicc-ks.com

Rruga "Čika Jovina" p/n, Mitrovicë Veriore

T: +381 (0) 64 44 04 662

M: +381 (0) 64 90 97 882

E: mi@euicc-ks.com

www.euicc-ks.com



ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË

Rruga e Kosovës 1, kutia postare 331,10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 51 31 200; Fax: +381 (0) 38 51 31 305

E-mail: delegation-kosovo@eeas.europa.eu

Web: <http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo>

© Bashkimi Evropian, 2016

ISBN 978-92-9238-354-1

doi:10.2871/713243